

FJALIMI HYRËS
DITA E HAPUR GLOBALE PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË NË
KOSOVË
ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUES SPECIAL I SEKRETARIT TË
PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-UT
Prishtinë
5 mars 2018

Mysafir të nderuar,
zonja dhe zotërinj,

Mire se vini në Ditën e Gjashtë të Hapur Globale për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë. Dita e Hapur Globale filloi në vitin 2010, me qëllim të rishikimit të implementimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të KB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Sot, ditët e hapura globale organizohen në mbarë botën, duke ofruar një mundësi unike për të avancuar tutje momentin historik të krijuar me këtë agjendë, dhe duke siguruar përkushtim të vazhdueshëm politik, veprim të bashkërenduar dhe reforma institucionale dhe kulturore nga të gjitha qeveritë, shoqëria civile dhe nga institucionet e grave.

Në Kosovë, pas zgjedhjeve të fundit parlamentare dhe komunale, dhe duke ditur rëndësinë e madhe të avancimit të fuqizimit të grave si një parakusht fundamental për barazi gjinore, këtë vit, Dita e Hapur Globale do të përqendrohet në pjesëmarrjen politike të grave. Kemi nderin të mirëpresim një grup të grave dhe burrave të shquar, të cilët përmes punës së tyre, guximit dhe përkushtimit, i kanë kontribuar fuqizimit të vetëdijesimit gjinor dhe ngushtimit të zbrazëtirës gjinore në politikën e Kosovës. Avancimi i pjesëmarrjes politike të grave është i bazuar në një zotim më të gjerë global; për pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave, dhe mundësi të barabarta për

leadership në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike. Ky zotim është po ashtu krucial për barazinë gjinore, që buron nga realizimi universal i potencialit të plotë të njerëzimit, dhe nga zotësia e secilit si kusht i domosdoshëm për funksionim më të mirë të një shoqërie demokratike, me zhvillim gjithëpërfshirës dhe paqe të qëndrueshme. Për më tepër, pjesëmarrja politike e grave është e domosdoshme për drejtësinë gjinore për t'i dhënë fund pabarazisë, nënshtrimit, statusit hierarkik dhe pushtetit politik të paekuilibruar.

Mysafir të nderuar,

Në disa fusha, Kosova ka bërë përparim pozitiv lidhur me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin politik të grave. Çdo ditë gratë shërbejnë si shembull, nga zgjedhja e kryetares së parë femër të komunës në Kosovë deri tek drejtimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në zgjedhjet parlamentare të vitit të kaluar, gati një e treta e grave parlamentare u zgjodhën pa nevojën e kuotës. Një zhvillim tjetër pozitiv është se dy nga pesë zëvendëskryetarë të Kuvendit të Kosovës janë gra, dhe shtatë nga 14 komisionet parlamentare kryesohen nga gratë.

Mirëpo, përvoja e zgjedhjeve të fundit ka treguar se, pjesëmarrja efektive e grave në politikë jo domosdoshmërisht konvertohet në përfaqësim efektiv në vendimmarrje. Edhe pse kuqota është zbatuar, ka pas pengesa në përfaqësimin e grave në pozita udhëheqëse brenda partive, në qeveri dhe në organe të tjera vendimmarrëse. Në nivel qendror, përfaqësimi i grave në pozita udhëheqëse ka qenë i dobët në mungesë të ndonjë femre kandidate për kryeministër, për kryetare të Kuvendit dhe me të qenit të gjithë burra lidhshipi i partive kryesore politike. Nën qeverinë e posa themeluar, nuk ka femra zëvendëskryeministre dhe vetëm dy femra janë ministre. Në nivel lokal, nga 204 kandidatë për kryetarë të komunave, vetëm tetë ishin gra. Mirëpo,

kur flasim për fuqizimin e grave dhe pjesëmarrjen e tyre politike është më e domosdoshme që ne të shkojmë tej simbolizmit dhe numrave. Kuotat dhe numrat e grave që shërbejnë si udhëheqëse të institucioneve nuk mjaftojnë vetvetiu për të realizuar barazinë gjinore.

Edhe pse gratë përbëjnë gati 50 për qind të popullatës së Kosovës, pjesëmarrja e tyre në nivel qendror dhe lokal mbetet tek kufiri i 30 përqindëshit, që do të thotë se ndonëse kuotat janë plotësuar, zërat e grave në politikë akoma nuk dëgjohen në mënyrë të barabartë. Kjo sfidë, fatkeqësisht, është e zakonshme në mbarë botën. Pjesëmarrja e barabartë dhe kuptimplotë është e rëndësishme sepse gratë dhe burrat i sjellin politikës secili përvoja dhe pikëpamje unike që e rrisin cilësinë e debatit dhe e begatojnë e ekuilibrojnë perspektivat politike mbi çështjet shoqërore, ekonomike dhe politike.

Ndonëse në Kosovë ka disa barriera për pjesëmarrjen politike efektive të grave, tri kushte janë kruciale:

- **E para**, të rritet pjesëmarrja e grave në politikë duke luftuar normat patriarkale të rrënjosura thellë, dhe duke siguruar që klima politike të jetë e lirë nga stereotipizimi dhe dhuna negative gjinore.
- **E dyta**, të sigurohet përkrahje e konsiderueshme nga partitë politike dhe veçanërisht nga lidershpi i partive për kandidatet femra dhe për fushatat e tyre.
- **E treta**, të rritet përkrahja për ndërtimin e kapaciteteve për gratë e zgjedhura dhe të shtohen zërat e tyre, meqë kjo do të intensifikojë ndikimin e tyre në proceset vendimmarrëse.

Mysafir të nderuar,

Shpresoj se Dita e Hapur Globale këtë vit do të ofrojë një mundësi të rëndësishme që të potencohen përvojat e grave kandidate, duke përfshirë edhe të arriturat që janë bërë dhe pengesat e vazhdueshme me të cilat gratë vazhdojnë të përballen për arritjen e një barazie më të madhe në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet. Diskutimet tona sot ofrojnë po ashtu edhe një mundësi të veçantë që të shikojmë përtej numrave dhe të kuptojmë kontekstin dhe faktorët më të thellë që mundësojnë dhe pengojnë pjesëmarrjen dhe ndikimin e barabartë të grave. Ne shpresojmë se kjo ngjarje do të rezultojë po ashtu edhe me disa rekomandime konkrete për të mbështetur ndryshimin e mundshëm politik dhe legjislativ.

Kam kënaqësinë që të pranishëm e kam zëvendëskryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Halitin, i cili merr pjesë në këtë ngjarje së bashku me shumë liderë politikë të rëndësishëm dhe frymëzues, si dhe një grup i gjerë i ekspertëve nga “think tanks” dhe shoqëria civile, të cilët e kanë monitoruar dhe analizuar pjesëmarrjen e grave në Kosovë gjatë viteve. Në këtë sallë kemi edhe shpërfaqjen e disa liderëve të rinj, të cilët përmes veprimeve dhe përkushtimit të tyre sot janë duke punuar në ndërtimin e një fushe të barabartë të lojës në mundësitë e lidërshiptit nesër. Kemi po ashtu kënaqësinë që sot me ne janë edhe disa akterë ndërkombëtarë të cilët e kanë avancuar agjendën për gratë, paqen dhe sigurinë, në veçanti dua të përsëris dhe falënderoj praninë e miqve të mi Gjeneral Cuoci, COMKFOR, Ambasadorin Braathu, shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë, zyrën e Koordinatorit të KB-së për zhvillim, dhe përfaqësuesit nga organizatat simotra, EUSR, EULEX dhe Këshillin e Evropës dhe menaxherët e lartë të UNMIK-ut. Natyrisht, kemi kënaqësinë që këtë ngjarje e bashkëdrejtojmë me UN Women, partneri ynë i ngushtë brenda familjes së KB-së që ka qenë i angazhuar thellësisht në këtë temë gjatë këtyre viteve.

Pjesëmarrës të nderuar,

Më lejoni të përfundoj duke theksuar se pjesëmarrja e barabartë vetvetiu nuk është qëllimi i vetëm i asaj çka ne dëshirojmë të arrijmë, por është një hap përpara drejt synimit të grave dhe burrave në përpjekjet për ndikim të barabartë për ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme. Fjalët e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara António Guterres, “Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në qeverisje dhe vendimmarrje nuk bëjnë thirrje vetëm për agjendën për gratë, për paqen dhe sigurinë, por vazhdimisht dhe pozitivisht janë të lidhura me qëndrueshmërinë e paqes dhe perceptimet e qeverisjes së mirë.”

Ju falënderoj edhe një herë të gjithëve për pjesëmarrjen e juaj në këtë ngjarje, dhe shpresojmë se rezultatet e diskutimeve tona do të ndihmojnë për avancimin e mëtejshëm të implementimit të Agjendës së KB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë.

Faleminderit.